

REALIZIMI I PLAN PROGRAMIT MËSIMOR

Viti shkollor filloi me datën 2 shtator 1991, duke astrahuar përgaditjet për fillimin e vitit të ri shkollor, të cilat u mbajtën duke filluar që nga 20 gushti të vitit 1991.

Pasi që u punua prej 2 shtatorit deri me 5 shtator të vitit 1991, u kalua puna e tërë kolektivit në grevë kundër trusnive dhe kërcënimeve të pushtetit serb ndaj arsimit dhe shkollës shqipe.

Pas një ndërprerje të mësimit sipas udhëzimeve të ministrisë së arsimit të Republikës së Kosovës, ku u dha rëndësia për vazhdimin e punës mësimore me datën 15 Tetor 1991, ku u zhvillua 2 ditë me rradhë mesimi e pastaj u kalua në protestë të përgjithshme të arsimtarëve dhe të personalit tjetër të shkollës e cila protest zgjati 3 ditë.

Theksojm se edhe protestën policia e serbisë me tytat e automatikëve e ndërpreu në mënyre të skrupulltë dhe pa presedant procesin mësimor.

Në muajin Tetor në shkollën tonë, me ndihmën e forcave policore me plotë alief e vandalizëm nga pushteti serb erdhi personi i pa njohur i ashtuquajtur Ali Rashiti, për drejtor i dhunshëm i kësaj shkolle, të cilin prej asaj dite e gjere më tani asnjë punëtor i kolektivit tonë, nuk e përfillin dhe nuk e njohin.

Pasi që u dha kumtesa tjetër e Ministrisë së arsimit të Kosovës puna edukativo-mësimore u vazhdua me 20 Janar të vitit 1992.

Në të gjitha periodat në fjalë edhe pse ishin vështërsit shumë të mëdha, puna edukativo-mësimore u zhvillua në suaza jo normale, por me përpjekjet e vetëmohueshme të drejtorisë, mësimdhënseve e tjerë, rezultat ishin të kënaqshme.

Planëprogrami mësimor u zëri realizua në masë të plote sipas plane programite mësimore të reduktuara në kushte të jashtëzakonshme nga Ministria e Pleqesia e arsimit të Republikës së Kosovës,

Mësimi - puna edukativo-mësimore në këtë shkollë u fillua me 2 shtator të vitit 1991 dhe u përfundua me 30 qershor të vitit 1992.

Punën edukativo-mësimore e zhvilluan 57 mesimdhënës të mesimit lëndor dhe të atij klasor. Prej tyre vetëm një (1) ishte i pa kualifikuar i cili është duke e zëvendësuar një arsimtar të matematikës, i cili ishte delegate të Kuvendit të KSA-të Kosovës, e që edhe tani gjendet në egzil. Kemi bere përpjekje që edhe për këte kuader të sugjerojm të kualifikuar por ketij qellimi nuk ia arrihem ende, pasi që për zëvendësim nuk po na paraqiten arsimtarë të kualifikuar për këte lëndë mësimor.

Prishtinë,
01 korrik 1992.

Drejtori i shkollës,

/Kadri Z eqini/